

Pse duhet bërë?



Kontrolli i qafës së mitrës (smear test) është një nga mënyrat më të mira për t'u mbrojtur nga kanceri i qafës së mitrës.



Ju jep mundësi të zbuloni shenjat e kancerit në kohë, kur mund të trajtohen më me lehtësi.



Takimet për kontrolle të tilla shpëtojnë 4.500 jetë në vit në Mbretërinë e Bashkuar.



Nëse kanceri i qafës së mitrës nuk zbulohet në kohë, kjo mund të shkaktojë shqetësime të mëdha për familjen tuaj.

Mos ia lini shëndetin rastësisë.

Bëni kontrollin e qafës së mitrës tani.


Si funksionon?



Të gjitha gratë e moshës 25 deri në 64 vjeç kanë të drejtën të bëjnë kontrollin çdo 3-5 vjet.



Kur regjistroheni fillimisht te një mjek i përgjithshëm, do t'ju jepet mundësia të lini takim nëse ju ka ardhur koha.



Pas kësaj, do të merrni një letër çdo herë që vjen koha për një takim (çdo 3-5 vjet).



Në disa vende, mund t'ju kërkohet të shkoni në një klinikë, ku do të kontrollohen brenda ditës, pa lënë takim.



Më shumë se 7 në 10 gra në West Yorkshire shkojnë në takim kur i ftojnë.

Çfarë do të ndodhë?



Kjo do të bëhet nga një infermiere ose mjekë femër: mund të kërkoni që ta lini takimin diku tjetër nëse nuk ka personel femër të disponueshëm.



Para se të fillohet, do të merrni shpjegime se çfarë do të ndodhë dhe përgjigje për pyetjet që mund të kenë. Mund t'ju sigurohet një përkthyes.



Do të merret një kampion qelizash nga vagina me një furçë të butë.



Do të bëhet në më pak se 5 minuta.



Mund të merrni dikë me vete për mbështetje nëse doni.

Marrja e rezultateve



Rezultatet do t'i merrni zakonisht me letër 2 javë pas takimit.



Rezultatet e shumicës së njerëzve janë krejt normale.



Nëse rezultatet janë normale, çdo gjë është në rregull dhe do të ftoheni përsëri për 3-5 vjet.



Nëse zbulohet diçka e pazakontë, do të ftoheni përsëri brenda 1 viti, ose do të lihet një takim falas për në spital.



Procesi është i njëjtë për të gjithë dhe rezultatet tuaja nuk do t'i tregohen askujt tjetër.

Ndihmë dhe mbështetje

Këtu janë disa të dhëna kontakti të dobishme për të mësuar më shumë për kontrollin e qafës së mitrës

Mjeku i përgjithshëm vendës

Faqja e internetit <https://www.thewhitehousecentre.org.uk>

Email **0333 043 6243**

Adresa: **Whitehouse Centre, Princess Royal Health Centre, Greenhead Road, Huddersfield, HD1 4EW**

Migration Yorkshire

Faqja e internetit migrationyorkshire.org.uk

Email admin@migrationyorkshire.org.uk

Telefoni **0113 378 8188**

Adresa **4 Floor west, Merrion House, 110 Merrion Centre, Leeds, LS2 8LX**

The West Yorkshire & Harrogate Cancer Alliance:

Faqja e internetit canceralliance.wyhpnership.co.uk

Adresa **White Rose House, West Parade, Wakefield, WF1 1LT**

Jo's Trust:

Faqja e internetit www.jostrust.org.uk

Email info@jostrust.org.uk

Telefoni **0808 802 8000**

Adresa **Jo's Cervical Cancer Trust, CAN Mezzanine, 7-14 Great Dover Street, London, SE1 4YR**

National Health Service:

www.nhs.uk/conditions/cervical-screening



West Yorkshire and Harrogate
Cancer Alliance



Udhëzues i thjeshtë për Kontrollin e Qafës së Mitrës



Kontrolli për kancerin nuk është i rrezikshëm dhe është FALAS për njerëzit në Mbretërinë e Bashkuar



12.000 gra në ditë në Angli bëjnë takimin për kontrollin



Nëse keni ardhur kohët e fundit në Mbretërinë e Bashkuar, mund të regjistroheni te një mjek për të bërë kontrollin